

RAPORT

i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) për verifikimin e standardeve për riorganizimin e Universitetit “Metropolitan Tirana” (UMT)

I. Plani i takimeve të GVJ

GVJ i ngritur nga BA kreu vizitën pranë UMT më datë 11 Maj 2019 dhe i realizoi të gjitha takimet e parashikuara sipas planit të miratuar nga ASCAL dhe UMT.

II. Dokumentet në dispozicion të grupit “ad-hoc”

Dokumentet që u vunë në dispozicion të GVJ janë:

1. VKM 357, datë 12.5.2010, Urdhër nr.519, datë 18.10.2011
2. Vendime/urdhëra për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit
3. Strategjia e zhvillimit të UMT
4. Strategjia e zhvillimit të ShPAL UMT
5. Statuti i UMT
6. Urdhri nr.611, datë 30.10.2018
7. Rregullore e brendshme e UMT
8. Struktura organizative e SHPAL UMT
9. Udhëzim mbi politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik
10. lista e stafit akademik të ShPAL UMT
11. Listë e stafit që kanë përfutuar bursë erasmus+
12. Listë e stafit të përfshirë në projekte kërkimore-zhvillimore
13. Listë e stafit të mbështetur financiarisht për botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore etj.
14. Planimetritë kontratat etj.
15. Lejet Higjienosanitare, Certifikate për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi
16. Rregullore protokoll arkiva
17. Print screen sekretaria online, website
18. Lista e programeve të studimit të ofruara nga UMT, para marrjes së statusit si universitet
19. Vendim Senati Akademik për miratimin e kuotave dhe kriterëve të pranimit 18-19
20. Model kontrate pune
21. Projekti në kuadër të programeve të doktoratës MARDS
22. Lista e laboratorëve në total, dhe atyre kërkimorë
23. Rregullore e Këshillit Studentor
24. Listë aktivitetesh dhe eventesh me dhe për studentët
25. Listat e koordinatorëve të programit dhe jobdescription i koordinatorit të programit
26. Programi i Bursave
27. Listë e Studentëve të punësuar në UMT
28. Kontrata e njohjes së orëve të punës në UMT
29. Listë e start up të inkubuar dhe listë e bootcamps për vitin akademik 2018-2019

III. Gjendja e infrastrukturës së UMT

Mbështetur në raportet e kontrollit të MASR dhe kontratat, planimetritë dhe dokumentacionin përkatës ligjor të vendosur në dispozicion nga institucioni, rezulton se UMT plotëson kriteret ligjore infrastrukturore për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

IV. Autoritetet akademike të UMT

UMT ka Senatin Akademik, Bordin e Administrimit si edhe organet e tjera kolegjiale drejtuese si më poshtë:

- Senati Akademik;
- Rektori;
- Dekanatet;
- Asambletë e personelit akademik;
- Këshilli i Etikës;
- Këshilli i Fakultetit;
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
- Bordi i Administrimit.

Këto autoritete ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me statutin e institucionit dhe rregulloret e brendshme të tij.

Autoritetet drejtuese të Universiteti "Metropolitan Tirana" janë:

- Rektori;
- Dekanët;
- Përgjegjësit e departamenteve;
- Drejtorët e qendrave të kërkimit;
- Zv/Rektori/ët dhe Zv/dekanët;
- Administratori i Universitetit;
- Administratorët e njësive kryesore.

Drejtimi i institucionit ndjek një metodologji konsultative, mbështetur edhe në ligj, ku propozimet bëhen në nivel departamenti: për shembull, buxhetet e propozuara për departamentet merren parasysh gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor, përpara se të miratohen nga Senati Akademik dhe, në fund, nga Bordi i Administrimit. Rrjedha e informacionit nga stafi në Senat, nëpërmjet departamenteve, dhe qarkullimi i vendimeve të marra nga Senati drejt stafit dhe studentëve është e efektshme. Menaxhimi dhe administrimi i institucionit dhe proceset vendimmarrëse parashikohen në mënyrë të përshtatshme për të qenë të kuptueshme nga stafi i të gjitha niveleve. **[Ev: Statuti, Organigrama, Rregullore e Brendshme, Listë e stafit akademik dhe administrativ, Kualifikimet e stafit akademik]**

Mbledhjet e Senatit Akademik, Bordit të Administrimit dhe departamenteve, realizohen në mënyrë periodike dhe përfshijnë një axhendë dhe shkresë mbështetëse. Rolet dhe përgjegjësit e stafit kyç në institucion, për shembull të dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve, përcaktohen në Statut. **[Ev: Statuti, Rregullore e Brendshme, Kontratat e Punës së stafit akademik]**

Institucioni sigurohet që të respektohen kufijtë e autonomisë së tij dhe që ta ushtrojë autonominë e tij brenda kufizimeve të legjislacionit. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë verifikon administrimin e institucionit dhe veprimtaritë e tij dhe është përgjegjës për përmbushjen e Standardeve Shtetërore të Cilësisë në nivel institucional. **[Ev: Statuti, Rregullore e Brendshme, Organigrama]**

V. Krijimi dhe riorganizimi i njësive kryesore në UMT

Universiteti Metropolitan Tirana (institucioni), i cili u themelua zyrtarisht në maj të vitit 2010, përbëhet nga tre fakultete të vendosur në tre ndërtesa moderne në Tiranë. Është riakredituar institucionalisht me Vendim nr. 8, datë 07.01.2016 me afat 5 vjeçar nga QAA – ASCAL, MASR. Institucioni funksionon mbi bazën e Statutit të ndryshuar, miratuar me Urdhër nr. 611, datë 28.09.2018 të Ministrisë të Arsimit “Për miratimin e Statutit të Universitetit “Metropolitan Tirana”.

Misioni i institucionit është: përgatitja e drejtuesve të rinj të biznesit shqiptar dhe specialistëve të lartë në fushën e inxhinierisë, arkitekturës, ekonomisë dhe teknologjisë së informacionit, të aftë për të punuar si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë rajonal dhe evropian.

MASR ka miratuar Statutin e Universitetit “Metropolitan Tirana” në shtator 2018, pas miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik i institucionit. Statuti është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë për institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Ai përcakton misionin, organizimin dhe veprimtarinë e institucionit, duke përfshirë funksionimin e komisioneve, llojet e programeve të ofruara, të drejtat dhe detyrimet e studentëve dhe rekrutimin e stafit. Institucioni përcaktohet si universitet jopublik i arsimit të lartë që ofron programe të nivelit Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave dhe Doktoraturë, si dhe programe profesionale dhe programe të formimit të vazhduar. Programet e studimit menaxhohen nga departamentet dhe fakultetet përkatëse. [Ev: Statuti, Urdhri nr. 611 MASR]

Institucioni organizohet për të garantuar efektshmërinë e menaxhimit, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. Siç pasqyrohet edhe në organigramë, institucioni përbëhet nga 3 fakultete, 8 departamente dhe 1 qendër kërkimore dhe njësi mbështetëse administrative:

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT;
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;
- Fakulteti i Ekonomisë.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Kjo strukturë siguron ndarjen e funksioneve akademike dhe administrative. Statuti përcakton marrëdhënien ndërmjet shoqërisë themeluese dhe strukturave institucionale, duke përfshirë autonominë e secilit subjekt dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë. Kjo strukturë përputhet me kërkesat ligjore dhe përmbush standardet ligjore lidhur me numrin e stafit dhe studentëve, kapacitetin dhe infrastrukturën institucionale dhe kualifikimet e stafit. Institucioni ka autonomi të plotë dhe liri akademike në mësimdhënie dhe kërkimin akademik, në përputhje me Statutin të tij. Kjo përfshin liri për të përzgjedhur stafin e tij, për të ofruar programe studimi, për të krijuar lidhje bashkëpunuese me

universitete dhe kolegje të tjera, për të pranuar studentë dhe për të menaxhuar burimet në pronësi të ligjshme të institucionit. Struktura institucionale organizohet në njësi mësimdhënie dhe kërkimi, që mbështeten nga organet administrative. Në Statut përcaktohen edhe rolet e Bordit të Administrimit, Senatit Akademik, Komisioneve të Përhershme, Këshillit të Etikës, Këshillit të Sigurimit të Cilësisë, Rektorit, Administratorit, dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve. [Ev: Statuti, Urdhri nr. 437 i MASR, Organigrama, Listë e stafit akademik dhe administrativ, Kualifikimet dhe kontratat e punës të stafit, Kontratat e qerasë]

Koment:

- Sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, neni 23 pika 2, në përbërje të Fakultetit (njësisë kryesore duhet të jenë 3 njësi bazë, nga të cilat minimalisht 2 duhet të jenë Departamente. Kështu që ky kriter plotësohet.
- Nga analiza e programeve të ofruara nga departamentet e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës rezulton se programet e studimit të ofruara nga ky fakultet janë tërësisht brenda fushës së ekspertizës së fakultetit. Ky kriter plotësohet.
- Përbërja dhe emërtimi i Departamenteve është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, si dhe me fushat e studimit dhe veprimtarinë akademike që ofrojnë. Ky kriter plotësohet.

V.1.2. Përbërja dhe kualifikimi i personelit akademik sipas departamenteve

• **Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof. Dr.
- 2 Dr.
- 2 Drnt.
- 2 Msc.

• **Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 2 Prof. Assoc.
- 1 Dr.
- 2 Drnt.
- 2Msc.

• **Departamenti i Shkencave të Natyrës.**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 2 Prof. Dr.
- 1 Prof. Assoc.
- 1 Dr.
- 1 Docent
- 1 Drnt.
- 1 Msc.

Koment:

- Lidhur me numrin e personelit me kohë të plotë të një departamenti (PAE), sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, duhet të jenë minimalisht 7 anëtarë me kohë të plotë. Ky kriter plotësohet për të tre departamentet.

- Nga krahasimi i përbërjes së stafit përpara riorganizimit me 3 fakultete dhe pas riorganizimit në 3 fakultete, ka rritje të stafit akademik me rreth 30%. UMT ka rekrutuar staf të huaj ose me eksperiencë në vende të huaja, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave ndërkombëtare dhe përafrimin me sistemin ndërkombëtar të arsimit të lartë.
- Institucioni dhe konkretisht Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës përmbush kriteret ligjore mbi kualifikimin dhe fushën e ekspertizës të personelit akademik, për të vlerësuar saktë përkatësinë e formimit akademik me fushat e studimit ku janë angazhuar.

VI. Programet e Studimit

Institucioni ofron programe të nivelit Bachelor, Master, programe profesionale 2 vjeçare dhe programe të formimit të vazhduar në fushat e studimit të ekonomisë dhe inxhinierisë. Në statut parashikohet ofrimi i programeve të ciklit të tretë. Institucioni ka aplikuar pranë MASR për licencimin e programeve të doktoraturës, si dhe po implementon projektin MASRDS në partneritet me MASR në funksion të zhvillimit të shkollës doktores. Senati Akademik miraton numrin dhe kriteret për pranimin e studentëve, në vijim të propozimeve nga departamentet dhe në bazë të kuotave të lira. Disa programe studimi ofrohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Disa programe studimi ofrohen me profilizim në vitet e fundit të studimeve.

Programet e ciklit të parë Bachelor me kohë të plotë	Programet me karakter profesional 2 vjeçar
Inxhinieri Ndërtimi	Dizajn Grafik
Inxhinieri <i>Software</i> anglisht	Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente
Inxhinieri <i>Software</i>	Topografi dhe GIS
Informatike Ekonomike	Programet e Ciklit të Dytë Master Profesional me kohë të plotë
Informatike Ekonomike anglisht	në Marketing Dixhital
Inxhinieri Kompjuterike	në Banka dhe Sigurime
Administrim Biznesi	Programet të Formimit të vazhduar
Inxhinieri Elektrike me profile: Sistemet e fuqisë, Elektronike, Komunikime dixhitale, Kontroll Inxhinierik, Makineri Elektrike	Auditimi i Energjisë me profilin: Auditimi Energjistik në ndërtesa/në procese energjetike/në transport
Inxhinieri Elektrike me profile: Sistemet e fuqisë, Elektronike, Komunikime dixhitale, Kontroll Inxhinierik, Makineri Elektrike anglisht	Vlerësimi dhe Investimi i Pasurive të Paluajtshme
Financë, Bankë/Kontabilitet	
Arkitekture me profile: Arkitekt, Arkitekt interior, Bio-Arkitekt, Arkitekt Restaurues, Arkitekt Inxhinier	
Programet e ciklit të dytë Master i shkencave me kohë të plotë	
Inxhinieri Ndërtimi me profil : Struktura/Infrastrukturë në Transport	
Inxhinieri Elektronike	
Inxhinieri Telekomunikacion	
Inxhinieri Elektrike	
Ekonomik-MBA	

Menaxhim në Inxhinieri
Inxhinieri Informatike
Inxhinieri Mekatronike
Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku

Programet organizohen sipas parashikimeve ligjore në fuqi. **[Ev: Statuti, Listë e programeve të studimit sipas njësive bazë dhe atyre kryesore, Aktet e akreditimit të programeve të studimit]**

Programet e studimit synojnë kryesisht nevojat e tregut të punës në Shqipëri dhe në vendet fqinj. Konsiderohet si karakteristikë e **praktikës së mirë** specifitetet e profileve, që iu mundësojnë studentëve të përvetësojnë aftësi të specializuara në inxhinieri dhe ndërmarrje të nevojshme në Shqipëri. **[Ev: Listë e programeve të studimit sipas njësive bazë dhe atyre kryesore, Aktet e akreditimit të programeve të studimit, Aktet e Akreditimit Institucional]**

Senati Akademik vendos për ngarkesën vjetore të punës për stafin akademik. Përbërja e stafit akademik dhe kualifikimet e tyre mundësojnë zhvillimin cilësor të programeve. Gjithashtu thirren specialistë të fushës, kur është e nevojshme, si staf me kontratë. Si rrjedhojë, programet e studimit ofrohen në përputhje me kapacitetet institucionale. Programet e studimit të nivelit Bachelor në ciklin e parë i pajisin studentët me njohuri bazë dhe me parime të përgjithshme shkencore, që mundësojnë ecurinë në programet e studimit të nivelit Master të ciklit të dytë, ose i orientojnë studentët drejt punësimit, që mbështetet nga praktika profesionale gjatë programit. Programet e ciklit të dytë kanë një bazë në rritje të kërkimit dhe mbështeten nga punëdhënësit dhe palët e tjera të interesit. Ekzistenca e Qendrës Metroresearch si një organ specifik i kërkimit shkencor shpreh rritjen e veprimtarisë kërkimore shkencore të institucionit në funksion të zhvillimit të kurrikulës, si dhe në funksion të zhvillimit kualifikues për stafin. **[Ev: Statuti, Listë e stafit akademik sipas njësive bazë dhe atyre kryesore, Kualifikimet dhe Kontratat e stafit, Listë e programeve të studimit sipas njësive bazë dhe atyre kryesore, Aktet e akreditimit të programeve të studimit, Aktet e Akreditimit Institucional]**

Programet e studimit të nivelit Master të ciklit të dytë mbështeten në veprimtarinë kërkimore dhe stafi akademik përfshihet në veprimtarinë kërkimore. Teza e diplomës së Masterit përbën një mundësi për pjesëmarrje të studentëve në veprimtarinë kërkimore të zhvilluar nga stafi akademik dhe në punën me sektorin e industrisë. **[Ev: Statuti, Listë e programeve të studimit sipas njësive bazë dhe atyre kryesore, Aktet e akreditimit të programeve të studimit, Aktet e Akreditimit Institucional]**

Programet hartohen në përputhje me marrëveshjet e Bolonjës, në cikle të njëpasnjëshme; studentët pajisen me një diplomë dhe një suplement të diplomës si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. Kjo iu mundëson studentëve të transferojnë në këto programe dhe në programe të tjera, ose në vende të tjera evropiane. Fitimi i statusit Universitet ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkëmbimeve të eksperimenteve të studentëve dhe stafit akademik për vitin akademik 2018-2019 nëpërmjet programeve Erasmus+. **[Ev: Statuti, Listë e stafit akademik sipas njësive bazë dhe atyre kryesore, Kualifikimet dhe Kontratat e stafit, Listë e programeve të studimit sipas njësive bazë dhe atyre kryesore, Aktet e akreditimit të programeve të studimit, Aktet e Akreditimit Institucional, Listë e studentëve dhe stafit përfitues të bursave Erasmus +]**

Koment:

- Titujt e programeve të studimit të paraqitura janë në përputhje me kurrikulën që zhvillohet.
- Zhvillimi i programeve të studimit është në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, në përgjigje të tregut të punës dhe studentët ndiqen deri pas diplomimit, në punësim e më tej.

- Zhvillimi i programeve mundëson shkëmbimin e eksperiencave me universitete të huaja nëpërmjet programit Erasmus+.

VI.1 Gjendja e ciklit të tretë të studimeve

UMT ka aplikuar pranë MASR për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studimet e doktoraturës në:

- Shkenca të administrimit
- Shkenca kompjuterike dhe IT-së
- Shkenca të ndërtimit

UMT është në pritje të miratimit të aplikimit nga MASR, proces i cili është vonuar për shkak të mungesës së akteve nënligjore.

UMT po implementon projektin MARDS, në partneritet me MASR, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, homologët në Mal të Zi dhe Universitete partnere në Austri dhe Mal të Zi, me objekt ristrukturimin e standardeve të shkollës doktorale në arsimin e lartë në Shqipëri dhe Mal të Zi.

Në funksion të zhvillimit të procesit kërkimor në mbështetje të ciklit të tretë të studimeve, UMT ka investuar në zhvillimin e laboratorëve kërkimorë në fushat e Inxhinierisë së Ndërtimit, dhe asaj Kompjuterike e Elektrike. **[Ev: Projekt Aplikimi i studimeve të Doktoraturës, Projekti në kuadër të programeve të doktoratës MARDS, Listë e laboratorëve kërkimorë]**

Koment:

- Fushat e studimit ku UMT ka aplikuar për zhvillimin e studimeve doktorale përputhen me fushat e ekspertizës së institucionit, si dhe me kriteret ligjore të zhvillimit të këtyre programeve.
- Ofrimi i programeve të ciklit të tretë të doktoraturës është akoma në proces vlerësimi nga MASR për shkak të mungesës së akteve nënligjore.
- Implementimi i projektit MARDS në funksion të zhvillimit të shkollës doktorale ndihmon institucionin në avancimin e tij në këtë objektiv.
- Zhvillimi i infrastrukturës laboratorike mbështet zhvillimin e studimeve të thelluara të ciklit të tretë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Dr. Gjergji Thomai

Dr. Ilir Panda